



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:094438
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05730662

CA.nr.5244/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje nga gjyqtari Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit dhe antarët e kolegjit-gjyqtarët Lumni Sallauka dhe Faton Ademi, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të sigurimit-paditësit G. H. nga fshati D., Komuna e P., të cilin e përfaqëson me autorizim P. K., avokat në Gj., ndaj kundërshtarit të sigurimit-të paditurit E. H. nga Gj., me banim në lagjen D., objekti i kontestit vërtetim pronësie, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga propozuesi G.H., përmes të autorizuarit të tij, avokat P. K. nga Gj., kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.530/22, të datës 20.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **23.05.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË SI E PALEJUAR ankesa e propozuesit G. H. nga fshati D./Komuna e P., ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat P. K. nga Gj., kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.530/22, të datës 20.02.2024.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin e ankimuar, C.nr.530/22, të datës 20.02.2024, ka vendosur sin ë vijim

I. REFUZOHET i pabazuar propozimi i propozuesit G.H. nga fshati D., Komuna e P. për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, përmes së cilës ka kërkuar që *“të caktohet masa e përkohshme e sigurimit dhe të paditurit – kundërshtarit të sigurimit E. H. nga Gj. të i ndalohej që të bëjë tjetërsimin, të ndërtojë, të ngarkojë me barrë hipoteke apo të ndryshojnë gjendjen në çfarëdo mënyre tjetër të paluajtshmërisë, e cila evidentohet si parcelë kadastrale me numër 147-4, parcela arë e klasit të tretë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 501m², Zona Kadastrale Jahoc-*

Gjakovë. Zyrës Komunale Kadastrale në Gjakovë dhe noterëve kompetent në Gjakovë iu ndalohet të ndërmarrin çfarëdo veprimi me të cilin ndryshohet gjendja aktuale pronësore e paluajtshmërisë lëndore”.

II. Procedura në këtë çështje juridike-kontestimore do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës.

Kundër Aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar propozuesi, përmes të autorizuarit të tij, avokat P. K. nga Gj., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktvendimi i ankimuar dhe propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të aprovohet, apo i njëjti të anulohet dhe lënda të kthehet në ri vendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk është ushtruar nga kundër propozuesi.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 186, par.1, dhe nenit 196, në lidhje me nenin 310, par.5 si dhe nenit 208 dhe 209, pika a) të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e propozuesit G. H. nga fshati D./Komuna e P., ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat P. K. nga Gj., është e pa lejuar.

Gjykata e Apelit, fillimisht duke vlerësuar lejueshmërinë e ankesës së ushtruar, gjeti se e njëjta në kuptim të nenit 310 par.5 të Ligjit për Procedurë Kontestimore është e pa lejuar, për faktin se në këtë paragraph përcaktohet se “*Kundër aktvendimit mbi masën e përkohshme nuk lejohet ankimi*”, dhe nga përmbajtja e aktvendimit të ankimuar dhe propozimit të ushtruar nga propozuesi, konstatohet se i njëjti ka ushtruar padi me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit që i referohet nenit 306 të LPK-së, dhe gjykata e shkallës së parë trajtimin e propozimit dhe procedurën e zhvilluar e ka bërë sipas vendosjes së propozimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, dhe në rastin konkret propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit si propozim i pavarur ndaj propozimit për caktimin e masës së sigurimit nuk mund të ushtrohet, ngase sipas nenit 306 par.1 të LPK-së përcaktohet se “*Me propozim të propozuesit të sigurimit të paraqitur me propozim për caktimin e masës së sigurimit gjykata mund ta caktojë masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po që se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit*”, dhe në rastin konkret, meqë është vendosur lidhur me këtë propozim, atëherë edhe ankesa konform nenit 310 par.5 të LPK-së, nuk është e lejuar, ngase sa i përket vendosjes së propozimit për caktim të masës së sigurimit, i njëjti mund të ushtrohet vetëm si propozim urgjent në kuadër të propozimit për caktimin e masës së sigurimit dhe se gjykata ndaj këtij propozimi duhet të veproj vetëm nëse rrethanat konkrete përcaktojnë që vendosja duhet të bëhet pa dëgjim dhe njoftim paraprak të kundërshtarit të masës së sigurimit e në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 306 të LPK-së, prandaj, nisur nga të gjitha këto, gjykata e

shkallës së dytë vlerëson se në rastin konkret vendosja nga gjykata e shkallës së parë për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit nuk lejon ushtrimin e ankesës sipas nenit 310 par.5 të LPK-së, andaj, meqë gjykata e shkallës së parë nuk e ka bërë këtë, atëherë, gjykata ankimore referuar nenit 186, në lidhje me nenin 196 të LPK-së, ankesën e ushtruar nga propozuesi e konsideron të pa lejuar dhe si të tillë e hudhë poshtë.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e të lart cekurave, në mbështetje të nenit 186, par.1, dhe nenit 196, në lidhje me nenin 310, par.5 si dhe nenit 208 dhe 209, pika a) të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.5244/2024 me datë 23.05.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka